

VENDIM
Nr. 3, datë 19.1.2017

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E
RREGULLORES PËR GARANCITË FINANCIARE TË PJESËMARRËSVE PËR
REGJISTRIMIN NË TREGUN E ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; kapitullit III, pika III.2.4, të “Rregullave të përkohshme të tregut shqiptar të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 139, datë 25.8.2016; dhe nenit 26, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.1.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e “Draftrregullores për garancitë financiare të pjesëmarrësve për regjistrimin në tregun e energjisë elektrike”, të përgatitur nga drejtoritë teknike,

konstatoi se:

- Këto rregulla hartohen nga OST-ja dhe miratohen nga ERE në zbatim të kapitullit III, pika III.2.4 të Rregullave të Përkohshme të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike, miratuar me vendim të Bordit të ERE-s nr. 139, datë 25.8.2016.

- Me shkresën nr. 6583 prot., datë 18.10.2016, OST sh.a. ka dërguar në ERE kërkesën për miratimin e Rregullave për Garancitë Financiare të Pjesëmarrësve për Regjistrimin në Tregun e Energjisë Elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e “Draftrregullores për garancitë financiare të pjesëmarrësve për regjistrimin në tregun e energjisë elektrike”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OST sh.a. KESH sh.a., OSHEE sh.a., MEI-n, Autoritetin e Konkurrencës dhe palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti